

Nr. Prot.
Nr. 202300896/1 Dok.

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)- në Tepelenë.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Redi RAMA
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

TEPELENË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në I.E.V.P. Tepelenë.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)-në Tepelenë, cilësia e trajtimit të paraburgosurve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z. Redi Rama, i cili shprehu angazhimin dhe seriozitetin e duhur në trajtimin e çështjeve dhe gjetjen e zgjidhjeve si dhe grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer

vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në vijim Mekanizmi Kombëtar ose MKPT, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Tepelenë më datë 12.10.2023, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Besnik Deda me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi.

Objektivi kryesor i inspektimit në I.E.V.P. Tepelenë ishte vlerësimi i kushteve infrastrukturore që garantojnë sigurinë, jetesën, shëndetin dhe zhvillimin e aktiviteteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit ligjor t’ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime paraprake

Kjo ishte vizitë periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në I.E.V.P Tepelenë për vitin 2023. Inspektimi ishte i paparalajmëruar dhe u zhvillua pa mbikëqyrjen e stafit duke zhvilluar biseda konfidenciale me të paraburgosurit.

Drejtori i institucionit z. Redi Rama, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të paraburgosurve në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve, vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë, etj.

Ky institucion ka **një kapacitet maksimal prej 75 personash** i përcaktuar së fundmi me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me Nr.735 Prot, datë 04.05.2023. Në ditën e inspektimit në mjediset e institucionit ishin 118 persona të paraburgosur.

Rrjedhimisht pavarësisht rekomandimeve të bëra në vitet 2019, 2020, 2021, 2022 mbipopullimi vazhdon të jetë një problematikë e qenësishme. Për vitin 2022 Avokati i Popullit i ka rekomanduar institucionit “Marrjen e masave të menjëhershme për

reduktimin e mbipopullimit në I.E.V.P Tepelenë¹”. Në përgjigje të rekomandimit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve² na informoi se është analizuar situata e mbipopullimit në IEVP Tepelenë, dhe do të procedohet me transferimin e 80 të paraburgosurve. Por rezulton se kjo masë nuk ka qenë efektive në kushtet kur situata është shumë e rëndë me 43 persona ose 63% mbi kapacitet.

Gjendja e popullimit në IEVP Tepelenë për 6-mujorin e fundit paraqitet si më poshtë:

Muaji maj	82 paraburgosur / 7 persona mbi kapacitet;
Muaji qershor	95 paraburgosur / 20 persona mbi kapacitet;
Muaji korrik	105 paraburgosur / 30 persona mbi kapacitet;
Muaji gusht	104 paraburgosur / 29 persona mbi kapacitet;
Muaji shtator	115 paraburgosur / 40 persona mbi kapacitet;
Muaji tetor	118 paraburgosur / 43 persona mbi kapacitet.

I.E.V.P. Tepelenë rezulton të ketë mbipopullim të vazhdueshëm. Tejkalimi i normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet si shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit për person, si dhe për pasojë trajtim degradues e jo njerëzor. Shkelja e këtij standardi është evidentuar nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: “*Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi*”. Në disa dhoma gjendeshin nga 8-9 persona. Gjithashtu kishte 2 persona që flinin me dyshek në tokë.

Organika e I.E.V.P. Tepelenë përbëhej nga 99 punonjës nga të cilët 78 ishin punonjës të policisë së burgjeve dhe 21 punonjës civilë. Përgjatë inspektimit grupi i punës konstatoi se kishte, mungesë stafi të punonjësve civil, nga të cilat pozicione të rëndësishme për shërbimet e ofruara ndaj të dënuarve/paraburgosurve.

- Mjeku në institucion është me kohë të pjesshme.
- Në mungesë 2 punonjës në sektorin social (psikologu, punonjës social).
- Në mungesë 1 infermier.
- Në mungesë 3 punonjës të sektorit të policisë.

¹ Rekomandohet pëmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në IEVP Tepelenë Nr.Prot.K4/I30-2 Dt.05.10.2022.

² DPB kthim përgjigje Nr.11642/1Prot. Dt.04.11.2022.

Theksojmë se këto mungesa janë konstatuar përgjatë inspektimeve nga institucioni i Avokatit të Popullit prej vitit 2019 në këtë institucion dhe kjo problematikë ende nuk ka gjetur zgjidhje. Në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit për: “Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit”, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na bën me dije se në qarkun e Tepelenës numri i mjekëve është i vogël dhe e vetmja mundësi është punësimi i mjekut me kohë të pjesshme. Në lidhje me mungesën e Psikologut në institucion, DPB-e Burgjeve na bën me dije se është komunikuar me zyrat e punës Tepelenë, Përmet dhe Gjirokastër, por nuk ka kërkesa dhe interesim për t’u punësuar në këtë pozicion pune. Gjithashtu problemi që lind me një mbipopullim kaq të lartë prej 63% për disa vite rresht sjell problematikë edhe për numrin e duhur të organikës në staf, pasi organika e miratuar merr në konsideratë numrin në kapacitet të të dënuarve apo paraburgosurve.

Në bazë të Urdhrit të Ministrisë të Drejtësisë Nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Tepelenë është kategorizuar si burg i sigurisë së zakonshme paraburgim. I.E.V.P. Tepelenë përbëhet nga një godinë me 26 dhoma banimi.

Në bashkëbisedimin me drejtorin e këtij institucioni, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve/ paraburgosurve nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë së institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

- ✓ ***Ishte plotësuar rekomandimi*** për marrjen e masave për zbatimin e VKM për pagesën e të dënuarve që punojnë.
- ✓ ***Ishte plotësuar rekomandimi*** për të zbatuar detyrimin ligjor për komunikimin në çdo kohë pa pagesë me Institucionin e Avokatit të Popullit

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit një vit më parë nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar.

1. Nuk ishin marrë masat për reduktimin e mbipopullimit I.E.V.P. Tepelenë.
2. Nuk ishin marrë masat për plotësimin e vendit vakant të psikologut.
3. Nuk ishin marrë masat për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit.
4. Nuk ishin marrë masa për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire për krijimin e kushteve sa më dinjitoze brenda dhomave të banimit.

5. Nuk ishin marrë masa për mundësimin e komunikimit online nëpërmjet skype të të burgosurve me familjarët bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
6. Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve të përbashkëta në I.E.V.P Tepelenë.
7. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.
8. Nuk ishin marrë masat për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë për të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme të shëndetësore.
9. Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve në IEVP për ushtrimin e rriteve fetare.
10. Nuk ishin marrë masa për realizimin e kurseve profesionale bazuar në kërkesat dhe nevojat e të dënuarve me qëllim edukimin vazhdues të të dënuarve dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.
11. Nuk ishin marrë masa për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.

Në lidhje me moszbatimin e këtyre rekomandimeve, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se nuk ka asnjë veprim nga ana e institucioneve lidhur me plotësimin e rolit riintegrues që duhet të ketë I.E.V.P. Tepelenë.

Trajtimi

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte. Mekanizmi Kombëtar vlerëson këtë fakt dhe shpreh besimin që kjo frymë do të jetë e qëndrueshme.

Të paraburgosurit si shqetësim kryesor shprehën mbipopullimin në institucion. Përgjatë inspektimit konstatuam dhoma banimi me **7- 8 deri në 10 persona**. Po ashtu konstatuam se **dy persona flinin me dyshekë përtokë**.

Të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në I.E.V.P Tepelenë. Shkak për këtë ishte mungesa e psikologut dhe e punonjësit social si dhe mungesa e ambienteve të përbashkëta për kryerjen e aktiviteteve sociale dhe edukuese.

Gjithashtu sipas të paraburgosurve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore dhe ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët.

Ankesa kishte për mungesën e ambulancës. Sipas tyre në rast të paraqitjes së një komplikacioni shëndetësor të të dënuarit, makina e shoqërimit shërben si mjet për transportimin e tyre në spitalin rajonal, ose në spitalin e Gjirokastrës. Për drejtorin e institucionit mungesa e ambulancës është shqetësuese pasi në rastin kur ka lindur nevoja për transportimin e të dënuarve për mjekim në Tiranë, është e pamundur pasi për shkak të distancës së largët nuk mund të vihet në dispozicion makina e sigurisë.

Ankesa kishte gjithashtu edhe për mungesën e kurseve profesionale si dhe ato të gjuhës së huaj bazuar në kërkesat dhe nevojat e të dënuarve me qëllim edukimin vazhdues dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.

Ankesa të shumta vinin për kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit, të cilat jo vetëm që ishin me lagështirë të theksuar, por kishin mungesa në orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale. Sipas të paraburgosurve disa nga orenditë që kishin në dhoma i kishin marrë nga familjarët e tyre.

Ankesa kishte edhe për mungesën e ambienteve për ushtrimin e riteve fetare.

Një problematikë e ngritur pothuajse nga të gjithë të paraburgosurit ishte dhe pamjaftueshmëria në furnizimin me detergjente dhe mjete të higjienës personale.

Masat mbrojtëse.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit.

Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në I.E.V.P. Tepelenë ishin të instaluar 28 kamera të cilat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, dhe ruajtja e pamjeve filmike në server kryhej për 30 ditë.

Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen dhe kujdesin e veçantë të të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në I.E.V.P. Tepelenë funksiononte dhe ishte i pajisur me orendi.

Komunikimi me telefon me familjarët kryhej 8 herë në muaj nëpërmjet telefonave me kartë, të cilët ishin të instaluar në mjedisin e regjimit të brendshëm. Të dënuarit ngritën në mënyrë të përsëritur shqetësimin për uljen e minutave të bisedës në kartat telefonike, nga 120 min në 60 min kohë bisede, ndërkohë që çmimi i kartave ka mbetur i njëjtë nga kompania private e miratuar për ofrimin e këtij shërbimi. Nga verifikimi i aparateve telefonike me kartë u konstatua se, të paraburgosurit mund të lidheshin me numrin e telefonit të Avokatit të Popullit³.

Takimet me familjarë zhvilloheshin 4 herë në muaj por konstatuam se **komunikimi online nëpërmjet skype nuk zhvillohej, kjo një problematikë e përsëritur dhe e konstatuar edhe përgjatë inspektimit të Avokatit të Popullit në këtë institucion për vitin 2022.** Nga biseda me të paraburgosurit ata shprehën shqetësimin se për ta është e nevojshme komunikimi të paktën një herë në muaj nëpërmjet platformës skype pasi disa prej të paraburgosurve shprehnin se familjet e tyre janë larg dhe nuk mund të vijnë shpesh në takimet fizike. Ndërkohë në pikën 10 të nenit 70 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 209, dt. 6.04.2022 “ Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” parashikohet se: **Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë online.**

Në I.E.V.P. Tepelenë kishte një mjedis të veçantë për të paraburgosur që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike, por ky ambient kishte nevojë për investime dhe orendi për të qenë sa më i përshtatshëm.

³ Më Datën 11.04.2022 u botua në Fletoren Zyrtare nr.55 i Rregullores Së Përgjithshme të Burgjeve në të cilën është përcaktuar qartë se : I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur.

Në I.E.V.P. Tepelenë kishte 8 të paraburgosur që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: 1. *I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.* 2. *I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.”*

Nga takimi i grupit inspektues më të paraburgosurit që punonin brenda institucionit këta të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës. Ndaj tyre ishin lidhur kontratat e punësimit midis të paraburgosurve të punësuar dhe institucionit, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021, për shpërblimin financiar për punën e kryer.

Kushtet materiale.

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. I.E.V.P. Tepelenë është një institucion i vjetër i trashëguar nga sistemi komunist. Infrastruktura e godinës ofron dy kate akomodimi dhe ambiente ajrimi të jashtëm. Në çdo kat kishte nga 12 dhoma.

Seksioni i paraburgimit ka një dhomë veçimi e cila ka dritë natyrale dhe dritë artificiale. Gjithashtu është e pajisur me 2 shtretër me sfungjer.

Në institucion ndodheshin 8 të paraburgosur të moshës 18-21 vjeç. Nga takimi me të paraburgosurit ata nuk referuan raste dhune. 18-21 vjeçarët ishin vendosur në një dhomë e cila **kishte hapësirë të kufizuar. Ndërkohë që dhoma ishte për akomodimin e 4 personave në të gjendeshin 8 persona.** Kjo dhomë nuk u siguron këtyre të paraburgosurve hapësirën e nevojshme të parashikuar nga rregulloret. Gjithashtu ambienti i ajrimit për këtë grupmoshë ishte me hapësirë të kufizuar, e cila nuk lejonte mundësinë për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Paraqitja e godinës së banimit përbëhet nga 26 dhoma si më poshtë:

Kati i parë me 11 dhoma banimi me sipërfaqe të njëjtë 5.4 m x 2.5 m plus dy dhoma të cilat shërbenin, njëra si dhomë veçimi me përmasa 5.4 m x 2.5 m dhe dhoma tjetër e cila funksionon si tualet dhe dushe të përbashkëta me sipërfaqe 4 m x 2.5m.

Kati i dytë me 12 dhoma banimi me përmasa 5.5 mx 2.4 m. Të dyja katet kanë nga një korridor 27.5 metra të gjatë dhe 1.5 metra të gjerë.

Lidhur me kushtet në regjimin e burgut u vërejtën:

Dhomat të gjitha kanë ndriçim natyral dhe artificial dhe janë të pajisura me tualete. Të gjithë shtretërit janë të pajisur me dyshekë e të paraburgosurve u është lejuar mbajtja e televizorit dhe frigoriferit.

Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda. Ajrimi për katet kryhej në ambiente të veçanta të ndara nga njëra-tjetra. Në hyrje të godinës gjendej një ambient ajrimi i cili përdorej për grupmoshën 18-21 vjeçarë. Nisur nga situata e mbipopullimit edhe hapësira brenda disa dhomave, ishte e kufizuar. **Gjithashtu konstatoam se 2 të burgosur flinin me dyshekë në tokë**, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues. Vendimi Nr.209, datë 6.4.2022 *“Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”*, Neni 33 *“Mjediset e qendrimit dhe të fjetjes”* parashikon se: *“Në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar.”*.

Në I.E.V.P.Tepelenë përveç ambienteve të ajrimit dhe një klasë nuk ka ambiente të tjera të përbashkëta.

Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në një dhomë të përbashkët për të dy sektorët. Në këtë ambient të takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me kangjella hekuri. Një dhomë e vogël prej gati 2-3 m² sipërfaqe që gjendej në hyrje të godinës, **përdorej si ambient për prindërimin në distancë**, sepse kjo ishte e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së ambienteve shtesë.

Probleme kishte me higjienën e mjediseve nisur nga fakti që institucioni në tërësinë e tij ishte i amortizuar. Nga intervistat e bëra nëpër dhoma me të paraburgosurit pati shumë ankesa **për mungesën e investimeve** në I.E.V.P. Tepelenë për të garantuar cilësinë e higjienës brenda në institucion. Cilësia e ujit ishte e mirë dhe furnizimi në një pjesë të institucionit ishte 24 orë në ditë.

Në I.E.V.P. Tepelenë larja në dushe zhvillohej mesatarisht dy herë në javë. Dushet ishin të instaluar nga 2 në çdo regjim përkatësisht 2 në katin e parë të godinës dhe 2 në katin e dytë.

Lavanderia ndodhej në ambientin e jashtëm të regjimit. Ajo ishte e pajisur me një lavatriçe e cila përdorej për larjen e bataniqeve ndërsa teshat për larje të paraburgosurit i dërgonin në familje.

Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi. Në I.E.V.P Tepelenë punonin 4 (katër) kuzhinierë. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Ushqimi ofrohet rregullisht tre vakte, kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë. Kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Nga inspektimi u konstatua se sasia dhe cilësia e gatimit ishte sipas urdhrit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁴.

Përgjatë inspektimit u evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në I.E.V.P. Tepelenë nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Ata pohuan se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit për shkak se nuk e pëlqenin atë.

Në I.E.V.P. Tepelenë ishte implementuar sistemi i ri i blerjes on-line.

Referuar dokumentacionit evidentohet se furnizimi dhe përmirësimi për pajisjen me sasi të mjaftueshëm të produkteve bazë të higjienës për të pastruar dhomat ishte kryer rregullisht sipas furnizimit mujor për të paraburgosurit.

Regjimi dhe aktivitetet.

Gjatë inspektimit u vu re se nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta. Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan të kenë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Trajnime profesionale: Në I.E.V.P. Tepelenë nuk zhvilloheshin trajnime profesionale pasi në këtë njësi administrative nuk kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional apo organizata të ndryshme.

⁴ Urdhër i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë nr.1126 prot, datë 22.02.2022 dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.995/1 prot., datë 07.03.2022 “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”.

Përsa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se **aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta**. Aktivitetet psiko-sociale zhvillohen të mangëta për arsye të mungesës së psikologut dhe punonjësit social.

Institucioni kishte një klasë për edukimin dhe në të gjendeshin një numër i vogël librash. Ato viheshin në dispozicion të paraburgosurve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁵.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë si dhe vlerësimet periodike.

Shërbimi Shëndetësor.

Gjatë vizitës në I.E.V.P. Tepelenë si dhe nga intervistat me të paraburgosurit, problematikat u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistojnë kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloreshin me kontributet e sjellja nga familja. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P, Tepelenë përbëhej nga 1(një) mjek i cili ishte i punësuar me kohë të pjesshme, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog i punësuar me kohë të pjesshme dhe 4 (katër) infermierë, 1 (një) ndër të cilët ishte në mungesë.

Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme 4 orë në ditë. Mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda. Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në

⁵ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe në qëndrimet e KPT parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin lyer rishtas megjithëse si të gjithë ambientet e këtij institucioni, kishin nevojë për investime tërësore. Dhoma e infermierisë ishte e vogël me kushte të mira higjieno-sanitare dhe aty mbaheshin edhe një sasi e vogël ilaçesh për urgjencën. Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.⁶

Në I.E.V.P. Tepelenë u evidentua se të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor përgjatë vitit 2022 ishin transferuar në IEVP Fier, por duke nisur nga fakti që ky institucion në vazhdimësi ka patur një numër në rritje të paraburgosurish duke shkaktuar një mbipopullim të vazhdueshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se në I.E.V.P. Tepelenë duhet të krijohet një Sektor i Kujdesit të Veçantë për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor. Për këtë kategori duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull, por mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike si dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në I.E.V.P Tepelenë sipas kontratës tre paleshe ISKSH, depo farmaceutike funksiononte rregullisht.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe*

⁶ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5; *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”.*

të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme **për uljen e mbipopullimit nëpër sektorë**, fakt ky që është shoqëruar **me fjetjen në tokë të personave të dënuar**, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues të tyre.
2. Marrjen e masave për plotësimin e vendit vakant të psikologut dhe punonjësit social, mungesa të cilat kanë sjellë për të dënuarit e I.E.V.P. Tepelenë, mosrealizimin e plotë të aktiviteteve psiko-sociale dhe ndihmën e nevojshme, për përmirësimin e sjelljes dhe rehabilitimin e tyre.
3. Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire për krijimin e kushteve sa më dinjitoze brenda dhomave të banimit.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për mundësimin e komunikimit online nëpërmjet skype të të burgosurve me familjarët bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përbashkëta në I.E.V.P Tepelenë.
7. Marrjen e masave për mundësimin e një hapësire ajrimi më të përshtatshme për të plotësuar nevojat e grupmoshës 18-21 vjeçarë.
8. Marrjen e masave për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.

9. Marrjen e masave për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë për të paraburgosurit me probleme të shëndetësore.
10. Marrjen e masave për pajisjen e mjedisit të veçantë “dhomës së prindërimit në distancë” me orendi si karrige, tavolina dhe krijimin e një ambienti sa më familjar për fëmijët.
11. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve për ushtrimin e riteve fetare.
12. Marrjen e masave për realizimin e kurseve profesionale bazuar në kërkesat dhe nevojat e të paraburgosurve me qëllim edukimin vazhdues dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.
13. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit për qëllim rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.
14. Marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë në shërbim të të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.
15. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjiëno-sanitare në ambientet e I.E.V.P. Tepelenë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI